

Shqipëria Inteligjente: Prioritetet dhe Vizioni për të Ardhmen

PARTNERITETI ME AKTORËT E “HELIKËS SË 4-FISHTË”
(Qeverisja qendrore dhe vendore, Biznesi, Akademia, Shoqëria Civile)
PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË S3

Hotel Plaza Tiranë
Salla “Queen Geraldine”, Kati 3.
31 Tetor 2023
Ora 09:30 - 15:00

- Strategjitë e Specializimit Inteligjent (S3) janë ideuar dhe zhvilluar nga vendet dhe rajonet në Bashkimin Evropian (BE) si një mjet i ri për nxitjen e inovacionit dhe zhvillimit rajonal. Qasja S3 përfaqëson një koncept të politikës së inovacionit të bazuar në vendin respektiv, dhe synon të identifikojë disa fusha prioritare të ekonomisë rajonale/kombëtare ku ndikimi i investimeve publike në kërkim, zhvillim dhe inovacion mund të jetë shumë i rëndësishëm. Ai thekson potencialin e lidhjeve ndërsektoriale, përveç industrive tradicionale, dhe promovon diversifikimin në bazë të këtyre lidhjeve.
- S3 është pjesë e Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021-2024 në kontekstin e Procesit të Berlinit, si dhe e Agjendës së BE-së për Inovacionin
- në Ballkanin Perëndimor 2021-2027. S3 është, gjithashtu, pjesë e Kapitullit 20 “Sipërmarrjet dhe Politikat Industriale” dhe Kapitullit 25 “Shkenca dhe Kërkimi” në kuadër të integrimit të Shqipërisë në BE.

Shqipëria filloi procesin e përgatitjes së S3 dhe u regjistrua në platformën e Qendrës së Përbashkët të Kërkimit (JRC) të Komisionit Evropian për S3 në 2017. Ekipi shqiptar i S3 hartoi një udhërrëfyes për S3 bazuar në kuadrin e JRC dhe deri më tani janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për sa i përket zhvillimit të strategjisë në nivel kombëtar, duke vlerësuar dhe perspektivën rajonale. Sipas udhërrëfyesit të S3, Shqipëria finalizoi hapat e parë të analizës së kontekstit, përmes hartëzimit sasior dhe cilësor të potencialit ekonomik, inovativ, shkencor dhe teknologjik të vendit, duke identifikuar fushat e mundshme me prioritet vertikal dhe horizontal të S3, për t'u eksploruar më tej gjatë fazës së *Entrepreneurial Discovery Process* (EDP) si vijon:

Prioritete vertikale: Bujqësia, Peshkimi dhe Akuakultura; Prodhimtaria (Manufacturing); Energjia; Turizmi; Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit; Veprimtaritë e Shërbimeve Administrative dhe Mbështetëse (BPO).

Fushat e identifikuara ndërsektoriale: Ekonomia Blu, Ushqimi i Shëndetshëm Burimet e Rinovueshme të Energjisë, BPO të zgjeruara.

Për t'u eksploruar dhe zhvilluar: Cluster-at, Përfshirja e Diasporës, Kapitali Njerëzor/Aftësitë, Politikat e Bazuara në Evidenca, Politikat Industriale.

- EDP është një dialog gjithëpërfshirës midis palëve të interesuara në të gjithë sektorët, që njihen dhe si aktorët e "Helikës së Katërfishtë" (qeverisja qendrore dhe vendore, biznesi, akademia dhe shoqëria civile). Diskutimet mes këtyre aktorëve gjatë EDP-së, mbi bazën e gjetjeve të fazës pararendëse të mapping, ndihmuan në përcaktimin e fushave prioritare të S3 për Shqipërinë. Ekipi Kombëtar i S3, nën kujdesin e veçantë të Zëvendëskryeminstres Znj. Belinda BALLUKU, organizoi 32 evente (tryeza të rrumbullakëta dhe workshop) gjatë fazës së EDP, nga tetori 2022 deri në korrik 2023, nga të cilat 3 ishin workshop rajonale me vendet fqinje Kosovë, Mal i Zi dhe Maqedoni e Veriut, ku u përfshinë sipas një qasje të re metodologjike 1275 përfaqësues të aktorëve të helikës së 4-fishtë. Diskutimet në eventet e organizuara me fqinjët, janë përkthyer në rekomandime të rëndësishme politikash që adresojnë sfidat dhe mundësitë lidhur me fushat e përbashkëta prioritare. Gjithashtu, eventet rajonale kanë promovuar me sukses bashkëpunimin rajonal dhe njohjen e rëndësisë së tij në procesin e integrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Për më tepër informacion vizitoni faqen web: <https://s3albania.org/>

Për të diskutuar rezultatet e arritura deri më tani nga strategjia S3, duke theksuar rëndësinë që kanë patur të gjithë aktorët e përfshirë në proces, Qeveria Shqiptare organizon konferencën:

Shqipëria Inteligjente: Prioritetet dhe vizioni për të ardhmen

Diskutimet në këtë konferencë do të fokusohen në:

- ① **Prezantimin e rezultateve të EDP**
- ② **Rëndësinë e përfshirjes së të gjithë aktorëve në procesin e hartimit sipas një qasjeje të re nga poshtë-lart**
- ③ **Diskutime tematike sipas fushave prioritare të identifikuara gjatë procesit të S3**
- ④ **Angazhimi dhe gjithëpërfshirja e aktorëve deri në finalizimin e procesit**

Fushat me potencial zhvillimi inovativ të cilat u evidentuan në përfundim të EDP do të jenë dhe objekt diskutimi në panelet e konferencës:

- ① **Energjia e Rinovueshme dhe Burimet Natyrore**
- ② **Zinxhiri Ushqimor i Shëndetshëm dhe i Qëndrueshëm**
- ③ **Turizmi i Qëndrueshëm dhe i Larmishëm**

Në panele do të diskutohet edhe për ndërhyrjet horizontale/ndërsektoriale që evidentohen si hapa të nevojshëm drejt një specializimi të zgjuar të Shqipërisë si: zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe roli i arsimit, zhvillimi rural dhe mbajtja e talenteve, roli dhe angazhimi i diasporës, ndikimi i digjitalizimit dhe teknologjive të reja në zhvillimin ekonomik, aksesin në financa, etj.

Ju mirëpresim!

AGJENDA

09:30 - 10:00

Regjistrimi i pjesëmarrësve

Moderator: Znj. Aurora Sulçe

10:00 - 10:15

Fjalë përshëndetëse

Znj. Belinda Balluku

Zëvendëskryeministre & Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

10:15 - 10:35

Z. Emanuele Fabbri

Joint Research Centre, Komisioni Evropian

Kuadri i Strategjisë së Specializimit Inteligjent në kontekstin e procesit të integritetit në BE

Znj. Linda Pustina

Drejtuese e Ekipit Kombëtar të S3,
Këshilltare e Zëvendëskryeministres

Procesi i EDP-së së S3, një konsultim gjithëpërfshirës: gjetjet dhe prioritetet për të ardhmen

10:35 - 11:30

**Energjia e Rinovueshme dhe Burimet Natyrore:
Shqipëria drejt lidërshit rajonal***

Moderator: Z.Arben Shkodra

Sekretar i Përgjithshëm i Bashkimit të Prodhuësve Shqiptarë

Panelistët

Znj. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministre & Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z. Enea Karakaci, Drejtor i Përgjithshëm i OSHEE

Z. Constantin Von Alvensleben, CEO i Voltalia në Shqipëri

Z. Francesco Italiano, Managing Director, ENI SpA

PhD. Ledi Moisiu, Fakulteti i Gjeologji Minerave, Universiteti Politeknik i Tiranës

Znj. Rigela Gegprifti, CEO Statkraft Albania & Devoll Hydropower Sh.A.

Z. Dritan Nako, CEO Antea Cement Sh.A.

11:35 - 12:30

Inovacioni dhe Zhvillimi në Bujqësi: Transformimi në një Zinxhir Ushqimor të Shëndetshëm dhe të Qëndrueshëm*

Moderator: Z. Enio Civici

Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Panelistët

Znj. Anila Denaj, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Z. Balázs Révész, CEO Vodafone Sh.A.

Z. Fatbardh Sallaku, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës

Z. Arbi Bamllari, CEO Skaitech Shpk.

Z. Ylver Bylykbashi, Sweet Farm, Dishnicë, Korçë

Znj. Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare, Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural

12:35 - 13:30

Rrugëtimi i Shqipërisë drejt turizmit të ekselencës dhe ruajtjes së traditës*

Moderator: Znj. Florensa Haxhi

Drejtoresh e Zhvillimit të Biznesit, Korporata Shqiptare e Investimeve

Panelistët

Znj. Vilma Bello, Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Z. Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë së Vlorës

Prof. Asoc. Bernard Dosti, Zëvendësrektor, Universiteti i Tiranës

Znj. Nevila Dudaj, CEO Adriatik Hotel & Adriatik Tours Shpk

Znj. Blerina Bombaj, Kryetare e Shoqatës Shqiptare të Agriturizmit

Znj. Mariana Koceku, CEO Neomalsore, Nanbli, Vau i Dejës, Shkodër

Z. Sulejman Hysa, CEO Bee Therapy, Stërmas, Tiranë

13:35 - 13:45

Konkluzione

13:45 - 15:00

Bufet networking: Shije Shqiptare

*Diskutimi në panele do të fokusohet në tematikat e mëposhtme:

Paneli 1:

"Energjia e Rinovueshme dhe Burimet natyrore: Shqipëria drejt lidershit rajonal"

Në këtë panel do të diskutohet mbi rrugëtimin e Shqipërisë drejt energjisë së rinovueshme dhe ekselencës së burimeve natyrore, ku do të eksplorojmë vizionin strategjik të Shqipërisë për t'u bërë një lider rajonal në prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Ky vizion drejtohet nga një përkushtim për sigurinë afatgjatë energjitike, duke respektuar qëndrueshmërinë mjedisore, e arritur kjo nëpërmjet një tranzicioni të gjelbër përmes investimeve strategjike, teknologjive inovative bashkëkohore dhe reformave të vetë sektorit.

Shqipëria po punon për diversifikimin e burimeve të saj të furnizimit me energji të rinovueshme, duke synuar shfrytëzimin e energjisë diellore, erës, energjisë hidrike, gjeotermale, etj., me qëllimin e vetëm sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm në të ardhmen. Por në të njëjtën kohë do të investohet për kalimin nga një ekonomi lineare dhe hibride drejt një ekonomie qarkulluese, e cila ripërdor dhe riciklon burimet e rinovueshme, duke i përpunuar dhe nxjerrë elementët e dobishëm derisa të arrihet "Zero mbetje" në mjedis. Teknologjitë inovative në riciklimin e mbetjeve industriale

teknologjike për prodhimin e energjisë, jo vetëm që do të kishin impakt pozitiv në mjedis, pasi do të zeronin mbetjet, por do të promovonin efikasitetin e burimeve, shoqëruar me një qasje më miqësore me mjedisin. Shqipëria po promovon dhe planifikon kombinimin e burimeve të rinovueshme të energjisë për të siguruar jo vetëm plotësimin e nevojave kombëtare me 100% energji të rinovueshme, por dhe për ta exportuar atë, si dhe për të siguruar infrastrukturë fleksibël të rrjetit për të trajtuar në mënyrë efektive këto burime dhe për të lehtësuar shpërndarjen ndër-rajonale të energjisë.

Në panel do të diskutohet, gjithashtu, dhe mbi hapat që po ndërmerren për menaxhimin e qëndrueshëm të lëndëve të para, duke u fokusuar në mbështetjen e praktikave inovative dhe aplikimin e teknologjive të reja në kërkimin, shfrytëzimin dhe përpunimin eficient të tyre, në përputhje me objektivat e “European Green Deal” dhe “Zero waste” duke përfshirë praktikën miqësore me mjedisin, riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, apo teknologjitë e përpunimit të lëndëve të para dhe përfshirjen e aktorëve shqiptarë në zinxhirin evropian të furnizimit me lëndë të para minerare. Ky panel ofron një pasqyrë unike në rrugën e Shqipërisë drejt shndërrimit në një lider rajonal për energjinë e rinovueshme dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke nxitur dhe siguruar një të ardhme të qëndrueshme në sektorin energjitik, por në respekt dhe me përgjegjëshmëri ndaj mjedisit dhe duke e kthyer Shqipërinë në një aktor kryesor në peizazhin global të energjisë së rinovueshme dhe burimeve natyrore.

Paneli 2:

"Inovacioni dhe Zhvillimi në Bujqësi: Transformimi në një Zinxhir Ushqimor të Shëndetshëm dhe të Qëndrueshëm"

Diskutimet në panel do të përqendrohen në eksplorimin e vizionit strategjik për të transformuar Sektorin e Bujqësisë në një forcë dinamike për ofrimin e ushqimit të shëndetshëm, si dhe rolin e inovacionit dhe aplikimit të metodologjive të përpunuara për zhvillimin e një zinxhiri ushqimor të qëndrueshëm në Shqipëri.

Fokusi do të vihet tek inovacionet në praktikën e bujqësisë, bujqësisë organike dhe në procesin e certifikimit, që përmirëson prodhimin e produkteve bujqësore dhe atyre organike dhe adreson kërkesat e rritura për to, shqyrtimi i teknologjive të reja të përpunimit të ushqimit, duke promovuar markat vendase dhe produktet e territorit, dhe duke garantuar standarde të larta të sigurisë ushqimore dhe cilësisë, implementimi i AKIS (Sistemi i Informacionit të Njohurive Bujqësore) për të përmirësuar më tej sektorin, dhe mënyra se si inovacioni, kërkimi shkencor dhe teknologjitë e reja mund të përdoren për të promovuar prodhimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e zinxhirit të ushqimit dhe duke kontribuar njëkohsisht në mirëqenien e qytetarëve.

Masat që do të ndërmerren në të ardhmen për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe atë të turizmit janë të ndërthurura së bashku dhe me ato të zhvillimit rural dhe rajonal, dhe do të kenë një impakt të rëndësishëm në komunitetet rurale dhe zhvillimin e talenteve e të rinjve në këto zona për të siguruar kapitalin njerëzor të domosdoshëm për transformimin e këtyre sektorëve drejt vizionit të tyre ambicioz, dhe që do të impaktojë ndjeshëm këto rajone duke sjellë zhvillim dhe mirëqenie. Roli i edukimit, por dhe krijimi i kushteve për të rinjtë në këto zona, do të shërbejë si parakusht për një zhvillim smart të sektorit të bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera në zonat rurale, si dhe ndërtimit të një zinxhiri ushqimor të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm. Diskutimet do të përfshijnë kontributin e diasporës në inovacionin, zhvillimin dhe rritjen e Shqipërisë, duke përfshirë incentivimin e talenteve dhe shqiptarëve të suksesshëm që kthehen në vend, si dhe shkëmbimin e njohurive, ideve të reja dhe novatore.

Ky panel është një forum i rëndësishëm për të shkëmbyer ide dhe përvoja në lidhje me inovacionin dhe qëndrueshmërinë në sektorin e bujqësisë dhe zinxhirit të ushqimit, dhe për të reflektuar mbi ndikimin e këtij sektori në zhvillimin e komuniteteve rurale. Pjesëmarrësit do të ndajnë vizionin e tyre mbi transformimin në një zinxhir ushqimor të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm që kontribuon në mirëqenien e qytetarëve dhe rritjen ekonomike të vendit.

Paneli 3:

"Rrugëtimi i Shqipërisë drejt turizmit të ekselencës dhe ruajtjes së traditës"

Diskutimet do të fokusohen mbi vizionin strategjik që e sheh Shqipërinë si një destinacion kryesor të turizmit të qëndrueshëm dhe të diversifikuar, përmes përvojave autentike që promovojnë trashëgiminë e saj kulturore, peizazhet befasuese, mrekullitë e kulinarisë dhe ofertat e turizmit shëndetësor, që njëkohësisht synojnë të rrisin mirëqenien e komuniteteve lokale. Bota emocionuese e ekoturizmit dhe përvojave nga ferma në tryezë që lidhin vizitorët me fermat lokale, promovojnë prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit cilësor dhe organik vendas, mbështesin fermerët në shkallë të vogël dhe ruajnë dhe respektojnë ambientin, do të kontribuojnë në një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit duke ruajtur traditën, thesaret natyrore dhe kulturore të vendit, në përputhje me praktikën e përgjegjshme, dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore dhe sociale.

Ky panel do të jetë një mundësi shumë e mirë për t'u njohur me risitë teknologjike dhe inovacionin në sektorin e turizmit dhe se si mbështetja e tyre mund të transformojnë këtë sektor, duke e kthyer atë në vlerë të shtuar për zhvillimin ekonomik të vendit. Adresimi i emigrimit rural, mbajtja e talenteve, por dhe angazhimi i diasporës dhe ekspertizës shqiptare, duke sjellë njohuri, aftësi dhe rritur inovacionin, bashkëpunimin dhe projektet e përbashkëta, përbën një sfidë por dhe një mundësi që, përmes incentivave që synojnë rritjen e investimeve në zonat nga vijnë, krijimin e platformave dhe rrjeteve, dhe rritjen e ekosistemit të inovacionit, të luajnë një rol kyç në përcaktimin e një të ardhme smart dhe të qëndrueshme për Shqipërinë.

Ndryshimi global i nevojës për të rritur ndërvëprimin njerëzor dhe kulturor po sjell një ridimensionim të strategjive në rang botëror drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe, rrjedhimisht, është një aspekt që duhet hulumtuar dhe studiuar për të orientuar politikë bërjen bazuar në evidenca dhe planifikuar ndërhyrjet e duhura në fushën e turizmit në rang vendi, në nivel qendror dhe vendor, për të rritur jo vetëm impaktin në zhvillimin ekonomik të vendit, por dhe për të ndikuar në zhvillimin rural dhe rivitalizimin e këtyre zonave. Qasja e re mbi mundësitë e zhvillimit të pronave publike në zonat me interes zhvillimi do të ndikojë veçanërisht në sektorin e turizmit duke sjellë investime të reja dhe rritje të cilësisë.

Ky panel ofron një platformë për të gjithë aktorët për një diskutim frymëzues që eksploron të ardhmen e sektorit të turizmit në Shqipëri, impaktin e ideve të reja dhe novatore, si dhe rolin e diasporës, për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, dhe se si ky zhvillim do të ndikojë në të ardhmen e vendit dhe komuniteteve të tij.